



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:146218

Datë: 01.03.2021

Numri i dokumentit: 01550668

P.nr.814/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit N.R. nga fshati Llashticë, Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1775/2020, të datës 29.10.2020, PP.II.nr.1752/2018, të datës 26.11.2018 dhe PP.II.nr.1224/2020, të datës 31.08.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 04.02.2021, mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 01.03.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri N.R., nga babai F. dhe nëna A., e lindur A.1., i lindur me datë ... në Gjilan ndërsa me vendbanim në fshatin ..., Komuna e Gjilanit, i martuar, baba i 2 fëmijëve, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

I.

Prej datës së pa vërtetuar e deri më datën 22.01.2020, në kohë të papërcaktuar, në shtëpinë e tij në fshatin Llashticë të Komunës së Gjilanit, i pandehuri, si shfrytëzues i energjisë elektrike, në vazhdimësi, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka vjedhur energji elektrike, ashtu që pas kontrollimit nga zyrtarët e autorizuar të KEDS-it, është vërtetuar që i njëjti është shkyqur për shkak të borxhit, mirëpo më pas është konstatuar se i njëjti ishte lidhur direkt në rrjetin elektrik duke i futur daljet në hyrje, ku ka bërë harxhim të paautorizuar dhe në këtë mënyrë të dëmtuarës KEDS, i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

II.

Më datë 06.06.2018, në fshatin Llashticë, Komuna e Gjilanit, pas vërtetimit të gjendjes faktike të njehsorit, nga punëtorët e KEDS-it, është konstatuar se i pandehuri N.R., si shfrytëzues i energjisë elektrike, në mënyrë të paautorizuar është lidhur në mënyrë direkte duke e këputur bllobbën dhe duke bashkuar hyrje-daljet në një pikë, edhe pse i njëjti është shkyqur nga rrjeti elektrik për shkak të borxhit të akumuluar, kështu që i pandehuri me veprimet e tij të dëmtuarës KEDS, i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

III.

Me datë 26.12.2019, në kohë të pavërtetuar, në fshatin Llashticë, Komuna e Gjilanit i pandehurit në vazhdimësi në mënyrë të paautorizuar, ka shfrytëzuar energji elektrike, në atë mënyrë që derisa i pandehuri për shkak të mos pagesës së borxhit është shkyçur nga rrjeti elektrik, me rastin e kontrollimit punëtorët e autorizuar të KEDS-it, kanë konstatuar se i pandehuri me datë 21.09.2019 me datë 20.11.2019, 20.12.2019, 21.12.2019 dhe 26.12.2019 ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik duke futur daljet ne hyrje të njehsorit elektrik dhe në këtë mënyrë ka siguruar shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit, ashtu që si pasojë e këtyre veprimeve, është pamundësuar regjistrimi i shpenzimeve të energjisë elektrike dhe për pasojë tani të dëmtuarës të dëmtuarës KEDS, i ka shkaktuar dëm material në vlerë të papërcaktuar.

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës,

andaj, gjykata në bazë të nenit 4,38,39,46,47,48,49,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 248 e 365 të KPP-ës, të pandehurin N.R.:

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 (njëqindpesëdhjetë) ditëve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-distrikti në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë) euro si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, kundër të pandehurit N.R. nga fshati Llashticë, Komuna e Gjilanit, me datat 30.10.2020, 27.11.2018 dhe 01.09.2020, ka ngritur aktakuzat me numra PP.II.nr.1775/2020, PP.II.nr.1752/2018 dhe PP.II.nr.1224/2020, që të tria për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare dhe për faktin se ndaj të pandehurit N.R. në këtë gjykatë njëkohësisht ishin duke u zhvilluar 3 (tri) procedura penale në të njëjtën kohë, për vepra penale të njëjta, me qëllim të ekonomizimit të procedurës penale në kuptim të nenit 35 të KPP-ës ka marrë aktvendim të veçantë me të cilin i ka bashkuar procedurat penale ndaj të pandehurit edhe atë për lëndët P.nr.1090/18, P.nr.542/20 dhe P.nr.814/20 ndërsa me datë 04.02.2021, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit dhe i pandehuri. Në këtë seancë gjykata para leximit të aktakuzës prokurori i shtetit ka bërë ricilësimin juridik të veprës penale lidhja e

paautorizuar në shërbime nga neni 321 i KPRK-ës në veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 i KPRK-ës meqenëse Kodi Penal me numër 04/L-074 është më i favorshëm për të pandehurin dhe më pas të njëjtat i ka ricilësuar në një veprë penale në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës meqenëse plotësoheshin kushtet ligjore për një gjë të tillë dhe më pas ka vazhduar me leximin e dispozitave të aktakuzave lëndore ku i pandehuri i lartcekur kishte deklaruar se i kishte kuptuar në tërësi aktakuzat dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë ndërsa sa i përket fajësisë i njëjti kishte deklaruar se e pranonte fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 248 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenin 248 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: procesverbalet me numër 2399789, i datës 14.04.2020, 2399012, i datës 14.03.2020, 2350069, i datës 15.02.2020, 2349786, i datës 22.02.2020 dhe 2344084, i datës 22.01.2020, kalkulimet RH me nr.298776, i datës 15.04.2020, 296228, i datës 17.03.2020, 293325, i datës 24.02.2020, 2924122, i datës 18.02.2020, 287638, i datës 23.01.2020, faturat DGLHP209161, e datës 15.04.2020, faturat DGLHP209054, e datës 17.03.2020, faturat DGLHP208947, e datës 03.03.2020, faturat DGLHP208910, e datës 18.02.2020, faturat DGLHP208808, e datës 23.01.2020, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, procesverbalet mbi konstatimin e gjendjes faktike në teren me nr.2352722, i datës 06.06.2018, fotografi mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale, kalkulimi i RH nga sektori i rikthimit të humbjeve, i datës 07.06.2018 dhe pro-faturë mbi dëmin e shkaktuar DGLHP186516, të datës 08.06.2018, procesverbalet e KEDS-it me nr.2494531, të datës 21.09.2019, 2345432, e datës 20.11.2019, 2351586, e datës 21.11.2019, 2345996, e datës 26.12.2019, foto dokumentacioni nga vendi ngjarjes, fatura nga sektori i rikthimit të humbjeve, të datës 23.09.2019, 21.11.2019, 22.10.2019, 23.12.2019 dhe 31.12.2019, faturat DGLHP198227, të datës 23.09.2019, faturat DGLHP198519, e datës 21.11.2019, faturat DGLHP198370, e datës 22.10.2019, faturat DGLHP198664, e datës 23.12.2019 dhe faturat DGLHP198703, e datës 31.12.2019 si dhe shkresat e tjera të lëndës gjithashtu gjykata me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartë cekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri N.R. ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-ës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i pandehuri me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe rrethanat personale të kryesit dhe atë se i njëjti është person i martuar, i papunë, mbajtës i familjes 4 anëtarëshe gjithashtu për të ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin ngase me parë nuk qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale. Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, ka kërkuar falje për këto veprime duke shtuar se këto veprime i ka bërë për shkak të gjendjes së varfër ekonomike, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës del i pandehuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe me qëllim të përfitimit të paautorizuar të energjisë elektrike për të cilët dihet se duhet të paguhet pranë të dëmtuarës KEDS. Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht i cili konsiston në atë se për veprat penale për të cilat parashihet dënim deri në 5 vite burgim (neni 47 i KPP-ës) vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme që të ndalojë kryesin të mos kryej vepra tjera penale.

Gjithashtu duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Duke pasur parasysh se në dispozitivat e aktakuzave është cekur vlera e dëmit mirëpo duke lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të përgjithshëm RH të cilën e bënë vet e dëmtuara gjykata konsideron se të njëjtat nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtë të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, të dëmtuarën KEDS për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

6.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzetë) euro si shumën prej 30 € (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.814/2020, me datë 01.03.2021

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermahaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjiilan.